



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-06

Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 23 qershor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe ex parte

Kërkesë urgjente për autorizim për nxjerrje informacioni në lidhje me Aktakuzën

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqiti një aktakuzë për konfirmim kundër Hashim THAÇIT, Kadri VESELIT, Rexhep SELIMIT, and Jakup KRASNIQIT ('të dyshuar') për krime të kryera në Kosovë dhe në pjesë të Shqipërisë që prej së paku marsit 1998 deri në shtator 1999 ('Aktakuza').¹ Aktakuza u paraqit konfidencialisht dhe *ex parte*,² dhe ZPS-ja ka kërkuar ndër të tjera mosnxjerrjen e përkohshme publike të Aktakuzës dhe dokumenteve në lidhje me të.³
2. ZPS-ja tashmë e ka vënë në dijeni gjykatësin e vetëm mbi përpjekjet e të dyshuarve për ndërhyrje ndaj hetimit të ZPS-së dhe administrimit të duhur të drejtësisë.⁴ Që prej asaj kohe ZPS-ja ka përcaktuar se veç këtyre përpjekjeve, ekzistojnë rreziqe të rënda dhe të menjëhershme ndaj hetimeve, ndjekjeve penale dhe proceseve prej një fushate që ende vazhdon prej Hashim THAÇIT dhe Kadri VESELIT për pengimin dhe sabotimin e mandatit të DHSK-së dhe ZPS-së. Në përgjigje të këtyre rreziqeve ndaj administrimit të drejtësisë, ndër të tjera ndërhyrjes së mundshme ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, ZPS-ja e gjykon të domosdoshme të nxjerrë publikisht pa vonesë informacion të kufizuar nga Aktakuza që identifikon THAÇIN dhe VESELIN si të dyshuar kundër të cilëve janë ngritur akuza dhe përkohërisht

¹ Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim, KSC-BC-2020-06/F00002/A01, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu* Kërkesë për paraqitjen e materialeve mbështetëse shtesë, KSC-BC-2020-06/F00006, 2 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; Vendim mbi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për paraqitjen e materialit mbështetës shtesë, KSC-BC-2020-06/F00007, 17 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

² Rregulla 86(2) e Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Nëse nuk përcaktohet ndryshe, çdo përdorim i termit 'rregulla(t)' i referohet Rregullores.

³ Kërkesë për fletarrestime dhe urdhra në lidhje me to, KSC-BC-2020-06/F00005, 28 maj 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Kërkesa për fletarrestime'). *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06/F00002, para.5.

⁴ *Shih për shembull*, Kërkesë për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para 4-5 (përkohërisht aftësia e të dyshuarve për të manipuluar organet qeveritare, për t'i bishtnuar dhe penguar procedimin kundër tyre dhe për të mobilizuar mbështetje shtesë), 7 (përkohërisht përpjekjet më të fundit të të dyshuarve, në veçanti, Hashim THAÇI dhe Kadri VESELI, për shfrytëzimin e pushtetit dhe ndikimit të tyre për sabotimin aktiv dhe pengimin e mandatit të DHSK-së), 8-17 (përkohërisht aktiviteti i provueshëm i të dyshuarve i ndërhyrjes dhe pengimit të zbatimit të ligjit dhe prova të përpjekjeve të të dyshuarve për ndërhyrje ndaj veprimtarive hetimore të ZPS-së), 18-26 (përkohërisht atmosfera endemike e ndërhyrjes dhe frikësimit të rëndë të dëshmitarëve në gjyqet kundër ish-anëtarëve të UÇK-së).

përgjithësisht natyrën e akuzave kundër tyre.⁵ Në nxjerrjen e këtij informacioni, ZPS-ja do të qartësojë se Aktakuza është thjesht padi penale dhe po shqyrtohet prej gjykatësit të procedurës paraprake i cili do të vendosë përfundimisht nëse do t'i konfirmojë akuzat.

3. ZPS-ja është e vetëdijshme për fazën aktuale të procesit dhe nevojës për respektimin e të drejtave themelore të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve. Ndonëse nxjerrja e informacionit të kufizuar të përshkruar këtu është e domosdoshme për arsye të jashtëzakonshme, po aq e domosdoshme është edhe mosnxjerrja në vazhdim e çdo informacioni dhe të gjithë informacionit tjetër të Aktakuzës dhe dokumenteve në lidhje me të deri në një urdhër tjetër për të vijuar garantimin e integritetit të procesit dhe mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimave.⁶

4. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 39(3) të Ligjit dhe rregullës 82(5), ZPS-ja kërkon urgjentisht autorizim nga gjykatësi i procedurës paraprake për nxjerrjen publike të informacionit të mëposhtëm nga Aktakuza:

- a. identitetet e Hashim THAÇIT dhe Kadri VESELIT si të dyshuar kundër të cilëve janë ngritur akuza; dhe
- b. numrin e akuzave, cilësimin juridik dhe natyrën e krimeve të pretenduara, numrin e përafërt të viktimave të njohura dhe përkatësinë ose prejardhjen e tyre etnike.

5. Ky parashtrim është rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 82(4).

Numri i fjalëve (në origjinal): 615

/nënshkrim/

Xhek Smith

⁵ *Shih gjithashtu*, rregullën 88(3). *Shih gjithashtu* Ligjin nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'), nenet 35(2)(f), 35(2)(l).

⁶ *Shih* Kërkesën për fletarrestime, KSC-BC-2020-06/F00005, para.55.

Prokuror i Specializuar

E martë, 23 qershor 2020

Në Hagë, Holandë